



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale
Mbledhja nr. 09
Ndërtesa e Kuvendit, salla N - 303
Prishtinë, më 15 prill 2015, në orën 13:00.

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR SHËNDETËSI, PUNË
DHE MIRËQENIE SOCIALE

Në mbledhje morën pjesë: Flora Brovina, Fikrim Damka, Fadil Beka, Hatim Baxhaku, Besa Baftiu, Time Kadrijaj dhe Shukrije Bytyçi.

Munguan: Njomza Emini dhe Adem Hoxha.

Stafi mbështetës i Komisionit: Shpresa Haxhijaj, koordinatore e Komisionit dhe Muhamet Bytyçi, zyrtar i fushës.

Mbledhjen e kryesoi, Flora Brovina, kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

REND I DITËS:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të komisionit, të mbajtura më: 18 dhe 24 mars 2015;
3. Shqyrtimi i raportit të grupit punues për monitorimin e zbatimit të Ligjit për Këshillin Ekonomiko-Social;
4. Të ndryshme.

***Kryetarja** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa asnjë ndryshim.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Komisionit, të mbajtura më: 18 dhe 24 Mars 2015

Kryetarja konstatoi se Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, miratoi procesverbalet e mbledhjeve të Komisionit, të mbajtura më: 18 dhe 24 mars 2015, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i raportit të grupit punues për monitorimin e zbatimit të Ligjit për Këshillin Ekonomiko-Social

Kryetarja – Fillimisht me lejoni të falënderoj grupin punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Këshillin Ekonomiko-Social, i cili e ka kryer një punë shumë të mirë dhe në një afat optimal e ka përmbushur planin e veprimit për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Këshillin Ekonomiko-Social. Fjalën ia dha kryesueses së grupit punues.

Time Kadrijaj – Ju faleminderit kryetare, po ashtu me lejoni që t’i falënderoj anëtarët e grupit punues të cilët me përkushtim ju kanë qasur punës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Këshillin Ekonomiko-Social.

Bazuar në mandatin e autorizuar nga Komisioni, Grupi Punues për mbikëqyrje të zbatimit të ligjit, grupi punues ka realizuar disa takime dhe vizita në terren. Gjithashtu, janë mbajtur takime të rregullta të grupit, qëllimi i të cilave ishte koordinimi dhe planifikimi i aktiviteteve. Grupi punues ka zhvilluar aktivitetet e nevojshme me qëllim të mbledhjes së informatave dhe të dhënave mbi nivelin e zbatimit të Ligjit dhe në fund ne kemi përgatitur këtë raport përmbledhës ku janë përfshirë edhe rekomandimet në lidhje me masat që duhet ndërmarrë për përmirësim të ligjit dhe zbatimit të tij. Ne kërkojmë që raportin të cilin e keni para vetes që të shqyrtoni dhe miraton dhe ky raport t’i dorëzohet Kryesisë së Kuvendit me kërkesën për debat dhe miratim të tij në seancë. Pas miratimit nga Kuvendi, raporti t’i adresohet Qeverisë së Republikës së Kosovës, përkatësisht Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Kryetarja- Unë propozoj që te pjesa e rekomandimeve, te pika 6, të bëhet *pagesa e anëtarëve të grupeve punuese dhe ekspertëve në përputhje me dispozitat ligjore*. Pas fjalës “grupeve punuese” të shtohet fjala “dhe ekspertëve”.

Pas diskutimeve Komisioni, *e mbështeti propozimin e kryetares dhe pas shqyrtimit të raportit, komisioni njëzëri miratoi raportin për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Këshillin Ekonomiko-Social*.

Kryetarja konstatoi se Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, njëzëri miratoi raportin për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Këshillin Ekonomiko-Social dhe nxori këto:

Përfundime:

- Raporti për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit Nr. 04/L-008, Për Këshillin Ekonomiko-Social t’i dorëzohet Kryesisë së Kuvendit me kërkesën për debat dhe miratim të tij në seancë. Pas miratimit nga Kuvendi, raporti t’i adresohet Qeverisë së Republikës së Kosovës, përkatësisht Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.
- Arsyetimin në seance lidhur me këtë Raport me Rekomandime e paraqet deputetja Time Kadrijaj, kryesuese e grupit punues.

4. Të ndryshme

Kryetarja: Kalojmë të pika e fundit të ndryshme, urdhëroni.

Besa Baftiu - Ju faleminderit kryetare, të nderuar anëtarë të Komisionit, unë dëshiroj ta ngriti një çështje dhe besoj se edhe ju jeni në dijeni për këtë problem. Çështja ka të bëjë lidhur me ndërtimin apo hapjen se shpejti të Spitalit të përgjithshëm Amerikan në afërsi të Qendrës Klinike Universitare, po ashtu ka paralajmërime se në pjesën e përparme të saj do të hapen edhe spitale të tjera private. Për këtë çështje besoj se jeni të informuar edhe ju. Andaj unë kërkoj nga ju që ne, si Komision, të dalim me një qëndrim se a jemi ne, që të mbrojmë pronën publike të QKUK-së, t'i mbrojmë Spitalet tona që në afërsi të tyre të mos lejohet ndërtimi, apo hapja e spitaleve private. Sipas informatave që kam ai spital në vitin 2005 fillimisht është dashtë të hapet në kuadër të klinikes universitare, si repart i kardiokirurgjisë masandej dr. Dalladakut ju ka lejuar për arsye se ka qenë një kuadër deficitar, pra ju ka lejuar që të hapet në afërsi të QKUK –së. Mirëpo me vonë është ndërruar destinacioni dhe i është dhënë dikujt tjetër. Pra unë po kërkoje që ne, si komision, të dalim me një qëndrim lidhur me këtë çështje.

Fikrim Damka- Unë propozoj që të dëgjojmë fillimisht ministrin e Shëndetësisë, pasi që ju ka parashtruar pyetje parlamentare, po ashtu propozoj se para se të dalim ne, si Komision me një qëndrim lidhur me këtë çështje të ftojme ministrin e Shëndetësisë edhe drejtorin e SHSKUK-së t'i marrim informatat e sakta dhe pas kësaj të dalim me një qëndrim.

Kryetarja- Edhe unë e kam qëndrimin tim lidhur me këtë çështje dhe natyrisht në pronën e dikujt nuk mundesh të ndërtosh, kurse sa i përket se a ndërtton afër apo larg nga spitali, kjo është një çështje tjetër. Ne, me Ligjin për Shëndetësi, kemi barazuar sektorin privat me sektorin publik madje edhe në Fondin për Sigurimet Shëndetësore janë të barabartë. Edhe unë pajtohem që të ftojme ministrin e Shëndetësisë edhe drejtorin e SHSKUK-së t'i marrim informatat e sakta lidhur me këtë çështje. Po ashtu me ministrin të bisedojmë edhe çështjen e sigurimeve shëndetësore pasi që janë ndarë do mjete buxhetore nga ana e donatorëve dhe kur do të fillojnë me implementimin e sigurimit shëndetësor.

Pas diskutimeve të shumta **kryetarja** konstatoi se Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, nxori këtë:

Përfundim:

- Më 22 prill 2015, të ftohet ministri i Shëndetësisë, z. Imet Rrahmani dhe drejtori i SHSKUK, z. Curr Gjocaj. Temë diskutimi do të jetë çështja e pronës së QKUK-së dhe e objekteve rreth QKUK-së, si dhe zbatimi i Ligjit për Sigurimin Shëndetësor.

Kryetarja: A ka dikush diçka të shtojë të kjo pikë? Jo. Atëherë ju faleminderit të gjithëve për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në orën 14:15.

E përqatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit

Flora BROVINA